

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair ZAGANJORI	Kryesues
Evelina QIRJAKO	Anëtar
Medi BICI	Anëtar

në datën 24.11.2016, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 02547/2014, që u përket palëve:

PADITËS: Tereze Ndreu

PALË E PADITUR: Bashkia Laç

OBJEKTI: *Kthim në vendin e mëparshëm të punës. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën që do të kisha fituar nëse marrëdhëniet e punës do të kishin përfunduar në fund të afatit të përfundimit të kontratës nga data 30.04.2012 kur më janë ndërprerë deri në datën 08.10.2013. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për mosrespektimin e procedurave të zgjidhjes së kontratës. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për vjetërsinë në punë.*

BAZA LIGJORE: *Nenet 144, 145, 146, 149, 155/1 të Kodit të Punës, kontrata individuale e punës.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 1231, datë 07.12.2012, ka vendosur: -Pranimin pjesërisht të padisë. -Rrëzimin e kërkesës për kthimin në punë. -Konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. -Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Laç ti paguajë paditëses Tereze Ndreu pagën që do të kishte fituar nëse marrëdhëniet e punës do të kishin përfunduar më datë 08.10.2013, pra në përfundim të kontratës me afat të caktuar. -Detyrimin e palës së paditur Bashkia Laç të dëmshpërblejë paditësen Tereze Ndreu me 5 (pesë) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. -Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Laç të dëmshpërblejë paditësen Tereze Ndreu për vjetërsi në punë me 4 (katër) paga mujore. -Rrëzimin e kërkesës për dëmshpërblim për mosrespektim të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës. -Këto dëmshpërblime të llogariten sipas pagës që ka marrë paditësja në momentin e largimit nga puna. -Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 255, datë 04.02.2014, ka vendosur: -Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes nr. 260 akti, datë 05.02.2013. -Dërgimin për kompetencë shqyrtimi Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1091, datë 26.03.2014, ka vendosur: -Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me nr. 1231, datë 07.12.2012.

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Bashkia Laç, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr. 1091, datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe pushimin e gjyqimit.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63/a të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit nr. 1091, datë 26.03.2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë dhe të vendimit nr. 1478, datë 07.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, si më poshtë:

-Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. -Detyrimin e palës së paditur Bashkia Laç të dëmshpërblejë paditësen Tereze Ndreu, me 5 (pesë) paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

-Detyrimin e palës së paditur Bashkia Laç të dëmshpërblejë paditësen Tereze Ndreu, me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit. -Detyrimin e palës së paditur Bashkia Laç të dëmshpërblejë paditësen Tereze Ndreu, me 4 (katër) paga mujore për vjetërsinë në punë.

Tiranë më 24.11.2016

Nr. 31003-02547-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-3387 i Vendimit (548)